

Presidenti turk Reccep Tyaip Erdogan së bashku me bashkëshorten e tij, Eminen, u përlotën nga emocionet në ceremoninë e hapjes së xhamisë në kalanë e Prezës për shkak të poezisë që recitoi një vajzë shqiptare.

BalkanWeb, zbardh tekstin e poezisë që recitoi vajza e mbuluar me shami:

*Je krenaria e botës islame, Presidenti ynë, prijësi ynë Reccep Tayip Erdogan*

*Minaret tona mos i lër pa ezan o Allah*

*Ose thirrni këtu ata që bëjnë mjaltë*

*Ose mos na lër pa zgjojet e bletëve*

*Këtu janë pa zë minaret*

*Vendin që është bërë mysliman mos e lër pa myslimanë o Allah*

*Këtu trupi im është pa dashuri o Allah*

*Na jep fuqi, mos e lër pa luftëtarë sheshin e xihadit o Allah*

*Vitet që presin heronj, mos i lër pa heronj o Allahu im*

*Të dimë të dalim kundër armiqve*

*Neve mos na lër pa shpirt o Allahu im*

*Ose ndaje vendin e mbetur pa kërrkënd, ose mos na lër pa çoban o Allahu im*

*Ti mos na lër neve pa ty, pa ujë e pa ajër o Allahu im*

*Vendin që është pjekur me myslimanë, mos e lër pa myslimanë o Allahu im*